

**KONTRATË THEMELIMI**  
**PËR SHOQËRINË TREGTARE**

**“E.T.M.” ShA**

**ME SELI NË KORÇË**

Sot më datë 16.12.2006, Ortakët Themelues:

1. **Enjti Pazaj**, i biri i Safetit dhe Nadirese , i lindur në Vlore , me datë 27.05.1954 banues në adresen Lagja 14, Rr. " Partizani " , Vila Nr 1. Korce, me arsim të larte, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me pasaportë me Nr. L.0166.930
2. **Dylber Kalemi**, i biri i Qaniut dhe Servetes , i lindur në Korce , me datë 17.11.1957 , banues në adresen Rr' 6 Deshmoret Nr 33, lagja 7 ne Korce, me arsim të mesem, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me pasaportë me Nr. L.1098.508
3. **Yllson Petriti**, i biri i Eminit dhe Humase , i lindur në Sovjan , me datë 01.01.1947 banues në adresen Lagja Nr 5 , rr. " Shaban Mukollari " , me arsim të mesem, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me pasaportë me Nr. L.065.54.98

**Deklaruan vullnetin e tyre të lirë dhe të pavesuar për themelimin e shoqërisë tregtare me termat që vijojnë:**

**NENI 1.**


Shoqëria Tregtare **“E.T.M.” Sh.A.** themelohet si Shoqëri anonime, bazuar në ligjin Nr.7638 datë 9.11 .1992 “Për Shoqëritë Tregtare”.

Ajo është Person Juridik Privat Shqiptar ne cilesine e shoqerise aksionere pa oferte publike. Emri i plotë i shoqërisë është **“Erald-Tani-Miri”** dhe emërtimi i shkurtër i saj do të jetë **“E.T.M.” SH.A.**

Selia e shoqërisë është në Rrugën Korçë - Voskopojë, **Korçë**, Shqipëri.

**NENI 2.**

Veprimtaria e Shoqërisë bazohet në normat e kësaj kontrate themelimi, Statutit të Shoqërisë, si dhe Legjislacionit Shqiptar në fuqi.



Themeluesit e saj mbajnë përgjegjësi vetëm për detyrimet që krijon Shoqëria.

### NENI 3.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2,000,000 (dymilion) Lekë. Ai është i ndare në 200 (dyqind) aksione midis themelueseve të Shoqërisë me vlerë nominale 10.000 lekë (dhjetëmijë) për çdo aksion.

Aksionet janë të numërtuara nga 1 deri në 200 përfshirë numrin e fundit të aksionit.

Aksionerët i zotërojnë aksionet në raportet e mëposhtme:

Nr	Emri mbiemri	Përqindja	Numri i aksioneve	Vlefata në Lekë
1	Enjti Pazaj	33.5%	67,00	670.000
2	Dylber Kalemi	33.25%	66,50	665.000
3	Yllson Petriti	33.25%	66,50	665.000
Totali		100%	200	2,000,000

Aksionerët përgjigjen për detyrimet karshi të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë

Vlerësimi dhe shlyerja e kapitalit themeltar është bërë nga Ortakët Themelues me rastin e miratimit të kësaj kontrate themelimi dhe është nënshkruar prej tyre. Vlerësimi i mëtejshëm i kapitalit themeltar nuk lejohet.

### NENI 4.

Shoqëria ka të depozituar në Banke, kapitalin në të holla, i cili depozitohet në llogarinë "Shoqëri në Formim e Sipër" dhe në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi.

Mbas regjistrimit të Shoqërisë kjo shumë do të kalojë në llogarinë e kësaj Shoqërie.

### NENI 5.

#### Objekti i Veprimtarisë të shoqërisë.

Shoqëria do të ketë si objekt të përgjithshëm të veprimtarisë së saj: Ushtrimin e aktivitetit tregtar në furnizimin, shitjen me pakicë dhe shumicë, transportimin dhe trajtimin e karburanteve të çdo lloji dhe vajrave lubrifikante të çdo lloji, në formën e import eksportit, si dhe çdo objekt tjetër veprimtarie në lidhje me to, të lejuar nga legjislacioni në fuqi dhe që nuk vjen në kundërshtim me Ligjin e mësipërm e me rregullat e përcaktuara me akte të veçanta nënligjore.

 Veprimtaria e "E.T.M." S.H.A do të konsistojë edhe në investimin e kontributeve të pjesëmarrësve në projektet e aplikuara nga shoqëria.

#### **NENI 6.**

#### **Kohezgjatja e shoqërisë.**

Kohezgjatja e shoqërisë do të jete 10 (dhjete) vjet. Kohezgjatja e shoqërisë mund të rinovohet duke u shtuar apo pakesuar me vendim të asamblese se ortakeve. Afati i fillimit të veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Rregjistrin Tregtar.

#### **NENI 7.**

Ortakët themelues mund të heqin dorë nga Shoqëria sipas menyrave të parashikuara në ligj, por gjithnjë për shkaqe të përligjura. Heqia dorë nuk i shkarkon Ortakët, nga detyrimet e Shoqërisë deri në momentin e heqies dorë.

#### **NENI 8.**

Investimet dhe veprimtaria e Shoqërisë gezojnë mbrojtjen e shtetit Shqiptar, i cili krijon të njëjtat kushte si për subjektet shqiptare ashtu edhe ato të huaja.

#### **NENI 9.**


Fitimi neto i Shoqërisë do të përdoret si vijon:  
10% Fond Garancie dhe shpenzime sipas vendimit të Asamblesë së përgjithshme.  
90% ju shpërndahet aksionerëve në formën e dividendit.  
Fitimi është lirisht i transferueshëm brenda edhe jashtë shtetit shqiptar.

#### **NENI 10.**

Ortakët Themelues kanë sidomos këto detyrime:  
-Të regjistrojnë Shoqërinë në Rregjistrin Tregtar dhe të marrin lejet e nevojshme të ushtrimit të aktivitetit të veprimtarisë së tyre.  
-Të derdhin kapitalin e nevojshëm për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë.  
-Të sigurojnë mjediset e nevojshme për fillimin e aktivitetit, makineritë, materialet e para e ndihmëse.  
-Të sigurojnë mundësitë e specializimit të fuqisë punëtore dhe specialistëve për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë.  
-Të sigurojnë objektet dhe makineritë e Shoqërisë nga çdo lloj dëmtimi.  
-Të menaxhojnë prodhimin e ta reklamojnë atë nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit.

#### **NENI 11.**

**Organet drejtuese të Shoqërisë janë:**



Asambleja e aksionerëve,  
Këshilli mbikëqyrës,  
Drejtoria.

Tre Anëtarët e parë të Këshillit Mbikëqyrës, të caktuar me statut, për një kohë tre vjet, janë: **Enjti Pazaj** – Kryetar, **Yllson Petriti** – Anëtar dhe **Adine Petriti** – Anëtare.

Drejtor i Shoqërisë "E.T.M." ShA do të jetë Zoti **Dylber Kalemi**. Ekspert i pare kontabël është zoti **Bashkim Gjata**.

#### **NENI 12.**

Ortakët themelues detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë.

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 13.**

Aksioneret mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat.

#### **NENI 14.**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga Ortakët themelues të Shoqërisë dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrveshjeve është Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

#### **NENI 15.**

Kontrata e themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues u nënshkrua prej tyre pa vërejtje para Noterit të vendit të themelimit të Shoqërisë.

### **ORTAKËT THEMELUES**

**Enjti PAZAJ**

*Enjti Pazaj*

*[Signature]*

**Dylber KALEMI**

*Dylber Kalemi*

*[Signature]*

**Yllson PETRITI**

*Yllson Petriti*

*[Signature]*